




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 26.11.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Znj. Afërdita Morina	Të pranishëm të tjerë
Z.Selman Kolgeci	Z. Enver Shabani	
Z. Flamur Bytyqi	Z. Driton Maliqaj	Kryetari Komunës
Z. Urim Suka	Z. Xhevxhet Gashi	Media dhe qytetarë
Z. Kushtrim Kuçi	Z.Edon Sadikaj	OSCE, LMT, KDI
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Jeton Rrakaqi	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi	Z.Bajram Basha	Z.Xheladin Sadikaj
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Mevlude Kabashi	
Z.Alban Berisha	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z. Bexhet Kuçi	Znj.Laureta Tafaj	
Z. Reshat Selimaj	Z.Liridon Fondaj	
Z. Lirim Qatani	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Aziz Bytyqi	Znj.Festë Kabashi	
Znj.Sanije Kuçi	Z.Herolind Limaj	
Znj.Besa Kuçi	Znj. Jehona Rrafshi	
Znj.Fidaije Kukaj		

REND DITE

- 1. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës;**
- 2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;**
- 3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Suharekës;**

Takimin e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit z. Shefket Kolgeci.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.

Pika 1. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës;

Shefket Kolgeci - lexon deklaratën e betimit dhe të gjithë asamblastët përsërisin fjalët pas tij.

Pika 2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;

Shefket Kolgeci - fton Kryetarin që ta jep betimin .

Kryetari - jep deklaratën e betimit.

Kryetari - përshëndet të pranishmit dhe mban fjalimin e rastit si Kryetar i Komunës.

Pika 3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Suharekës;

Avni Bytyqi - përshëndet të pranishmit dhe tregon procedurën e votimit për Kryesues të Kuvendit. Së pari duhet të zgjidhet komisioni për numërimin e votave dhe publikimin e rezultatit.

Shefket Kolgeci - propozon që komisioni të jetë prej 5 anëtarëve.

Unanimisht Miratohet

Shefket Kolgeci - kërkon që të jepen propozimet për për komision për numërimin e votive.

- 1. AAK** - z.Reshat Selimaj.
- 2. LDK** - Alban Berisha
- 3. PDK** - Bajram Basha
- 4. LVV** - Liridon Fondaj
- 5. Iniciativa Qytetare** - Herolind Limaj

Shefket Kolgeci - kërkon propozimin nga AAK për kandidatin për Kryesues për Asamble Komunale.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Në emër të grupit të AAK-së propozon z. Bexhet Kuçin për Kryesues të Asamblesë. Përshkruan biografinë e z. Bexhet Kuçit ,dhe njëherit fton asambleistët që ta mbështesin.

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Në emër të grupit të LDK-së propozon Selman Kolgecin për Kryesues të Asamblesë. Përshkruan biografinë e z. Selman Kolgecit.

Shefket Kolgeci - fton PDK për të propozuar kandidatin.

Jeton Rrakaqi - ne nuk kemi kandidat.

Shefket Kolgeci - fton LVV për të propozuar kandidatin.

Laureta Tafaj - ne nuk kemi kandidat por e mbështesim opozitën.

Shefket Kolgeci - pyet Iniciativën Qytetare se a kanë ndonjë propozim.

Herolind Limaj - nuk kam propozim për kandidat.

Shefket Kolgeci - pyet NISMËN për propozim për kandidat.

Jehona Rrafshi - ne nuk kemi kandidat dhe mbështesim pozitën.

Shefket Kolgeci - në bazë të propozimeve ne kemi dy kandidat z.Bexhet Kuçi dhe Selman Kolgeci.

Shefket Kolgeci - fton Asamblistët një nga një që të votojnë.

Komisioni fillon me numërimin e votave dhe konstaton se në kuti janë gjendur 31 fletëvotime. Pas numërimit të votave komisioni konstaton se :

- 1. Bexhet Kuçi - 19 vota**
- 2. Selman Kolgeci - 12 vota.**

Komisioni konstaton se z. Bexhet Kuçi zgjedhet Kryesues i Asamblesë Komunale.

Bexhet Kuçi - përshëndet të pranishmit. Falemnderon partite politike për mbështetjen dhe njëherit mban fjalim rasti për rizgjedhjen si Kryesues i Kuvendit Komunal.

Avni Bytyqi - njofton asamblistët se duhet të deklarojnë pasurinë e tyre.

Kryetari - uron Kryesuesin dhe fton Asamblistët që me date 28 Nëntor të bëjnë homazhe te varrezat e dëshmorëve.

Takimi përfundoi: **10:55**

Procesmbajtësja:
Dafina haziraj